

ABI INVEST Sha

RAPORT VJETOR

VITI I MBYLLUR 2022

ABI Invest Sha

ABI EIA

ABI FLEX EURO

ABI FLEX USD

Pasqyra e Lëndës

1. Rreth ABI Invest Sha	3
2. Vizioni.....	3
3. Misioni	3
4. Objektivat.....	3
5. Qeverisja Korporative	4
6. Transparenca.....	4
7. Kujdesi	4
8. Konflikti i Interesit	5
9. Përgjegjësia Sociale	5
7. Trajnime	8
8. Fondet e Investimit.....	8
9. Treguesit e Riskut	10

1. Rreth ABI Invest Sha

ABI Invest sh.a është liçencuar nga Autoriteti I Mbikëqyrjes Financiare në Mars 2020. Në Dhjetor 2020 dhe Qershor 2021, Autoriteti ka miratuar prospektet e fondeve të investimit nën administrimin e saj, respektivisht ABI EIA dhe ABI Flex EURO dhe USD.

ABI Invest sh.a ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Totali i aktiveve nën administrim të ABI Invest për mbylljen e vitit 2022 ishin rreth 5.9 milion Euro

2. Vizioni

Të jemi një partner i besuar dhe i përzgjedhur për klientët tanë duke i mbështetur ata drejt përmbushjes së objektivave të tyre financiare duke ofruar oportunitet për të shtuar vlerë dhe për të diversifikuar investimet e tyre. Të jemi një punëdhënës i standardeve më të larta dhe të kontribuojmë pozitivisht për zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në vendin tonë.

3. Misioni

Misioni ynë është të rrisim vlerën e investimeve të klientëve tanë duke duke realizuar kthime të kënaqshme nga investimi. Ne e realizojmë misionin tonë me anë të zbatimit të strategjive tona të investimit duke u mbështetur gjithmonë në vlerat dhe parimet tona që janë integritet, përkushtim, pozitivitet, profesionalizëm, dhe sofistikim.

Manaxhimi profesional i aseteve dhe kultura jonë e punës mundëson realizimin e misionit tonë çdo ditë.

4. Objektivat

T'u ofrojmë investitorëve një mënyrë investimi të qartë dhe transparente;

T'u japim investitorëve mundësinë për të vepruar së bashku, duke rritur avantazhet dhe mundësitë;

T'u ofrojmë investitorëve mundësi për diversifikimin e aseteve të tyre si dhe mundësi për përfitim në bazë të riskut;

Të edukojmë klientët tanë mbi mundësitë që ofrojmë dhe të rrisim gamën e produkteve në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

5. Qeverisja Korporative

ABI Invest sh.a është shoqëri aksionare, me seli në Rruga e Kavajës 27/1, Tiranë, Shqipëri. Aksionari i vetëm i shoqërisë është Banka Amerika e Investimeve Sha. Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratori

Këshilli i Administrimit:

Këshilli i Administrimit mbikëqyr zbatimin e politikave dhe strategjive të shoqërisë.

Këshilli përbëhet nga:

Kryetar	Z. Armand Muharremi , CFO – Banka Amerikane e Investimeve Sha
Zv, Kryetare	Zj. Teuta Lloshi , Drejtore e Thesarit, Banka Amerikane e Investimeve Sha
Anëtare Investimeve Sha	Zj. Brikena Hoxha , Drejtore e Departamentit Ligjor, Banka Amerikane e Investimeve Sha
Anëtar	Z. Redi Hakani , Administrator

Z. Redi Hakani

Administrator i Përgjithshëm

6. Transparenca

ABI Invest e trajton Transparencën ndaj Investitorit, si një pjesë të rëndësishme të aktivitetit të saj. Shoqëria publikon raportet periodike të saj dhe të fondeve nën administrim, çdo përditësim në dokumentacion, informacion për ecurinë ditore të NAV, çmimit dhe numrit të kuotave. Çdo investitor mund të kontrollojë nëpërmjet aksesit nga ëësite ëëë.abinvest.al llogarinë e tij ku mund të marrë informacion mbi ecurinë e investimit dhe të portofolit në tërësi.

7. Kujdesi

Administrimi i portofolit të fondit kryhet nëpërmjet një gjykimi të matur e të kujdesshëm, i parë në të njëjtin këndvështrim të atij të administrimit të financave dhe investimeve personale të vetë personelit kyç i cili ka në ngarkim këtë funksion. Përpjekje maksimale e transparente kryhen për

të maksimizuar ruajtjen e kapitalit të investitorëve me aplikimin e masave prudenciale të riskut pa prapaskaena arbitrazhi e spekulimi, por me synim përfitimi të pastër nga investimi.

8. Konflikti i Interesit

Shoqëria administruese, vepron në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj. Përdor aftësitë dhe dijet e nevojshme, vepron me korrektësi dhe me kujdesin e duhur. Ajo përdor me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë. Gjithashtu, shmang konfliktet e interesit në mënyrë që të garantojë që interesat e investitorëve në çdo lloj sipërmarrjeje të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të shoqërisë administruese të fondeve, interesat e tyre dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të.

9. Përgjegjësia Sociale

Të qenit pjesë e grupit ABI i cili ka në fokus të tij mbështetjen e aktiviteteve me karakter social ka bërë që ABI Invest të jetë pjesë e këtyre nismave që në nisje të aktivitetit të saj.

Më poshtë po shfaqim shkurtimisht, një përmbledhje të aktiviteteve të mbështetura nga ABI Bank, shoqëria mëmë e ABI Invest.

Të ndarë sipas objektivave më poshtë ABI Bank ka mbështetur projektet:

- **FONDACIONI SPITALOR I NENES DHE FEMIJES**

Banka Amerikane e Investimeve, mbështeti Fondacionin Spitalor të Nënës dhe Fëmijës në projektin “Kutia e Gëzimit” për një periudhë 1 vjeçare. Projekti konsistonte në dhurimin e paketave me veshje dhe produkte të higjienës për bebet e porsalindura, nënave nga shtresat vulnerabel në të gjithë vendin.

- **KRYQI I KUQ DHE KOMUNITETI MYSLIMAN SHQIPTAR**

Me rastin e muajit të Ramazanit dhe festës së Bajramit, Banka Amerikane e Investimeve ju përgjigj kërkesës së Kryqit të Kuq dhe Komunitetit Mysliman Shqiptar, për dhurimin e 150 paketave me produkte ushqimore, në mbështetje të familjeve më në nevojë të qytetit të Tiranës.

- **QËNDRA KOMBETARE TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PER FEMIJET**

Banka Amerikane e Investimeve, mbështeti Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijë në Tiranë, si një institucion publik i specializuar në fushën e shëndetit mendor dhe fizik. Projekti synoi përmirësimin e mjediseve fizike të institucionit, si një mënyrë për të garantuar një cilësi shërbimi më të mirë të ambjentëve terapeutike.

- **RRATHE DHURUES 2022**

Në 16 Qershor, u zhvillua Ankandi i Dhurimit “Rrathë Dhurues 2022” nga "Partnerët Shqipëri" me qëllim promovimin dhe zhvillimin e filantropisë në Shqipëri duke ofruar mbështetje financiare për

3 kauza të cilat do t'i vinë në ndihmë komuniteteve në nevojë. Banka Amerikane e Investimeve ofroi mbështetje për dy prej kauzave të prezantuara:

- **“Pop-up Book!”** një iniciativë që do të kontribuojë në krijimin e një hapësirë miqësore, letrare dhe inovatore në ambjentet e shkollës “Ferraj” e cila frekuentohet nga 148 nxënës.

- Kauza e dytë **“Nadja e mirë gjyshërit tanë”** iniciativë që do të kontribuojë në ndërtimin e një hapësirë rekreative për moshat e treta në qytetin e Shkodrës.

- **FEM – FEST**

Banka Amerikane e Investimeve, mbështeti edicionin e parë të Fem – Fest në Shqipëri. Festivali i parë feminist që u zhvillua nga datat 5-8 Mars, synoi ndërgjegjësimin e opinionit publik për të drejtat e grave nëpërmjet shfaqjeve, instalacioneve, ekspozitave, paneleve të diskutimit dhe mundësive për artistet e reja.

- **MBREMJA GALA E BAMIRESISE “LOVE IS ALL”**

Në kuadër të luftës kundër diskriminimit, Banka Amerikane e Investimeve mbështeti për të pestin vit radhazi “Mbrëmjen Gala të Bamirësisë” të organizuar në Tiranë në datën 31 Maj, nga aktivistët e komunitetit LGBT. Misioni i këtij eventi ishte sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psikosociale, aftësimin për jetën, edukimin dhe punësimin për të rinjtë LGBT, të cilët janë viktima të abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës “Streha”.

- **PROJEKTI PILOT PER “A.D.H.D” NE SHQIPERI**

Banka Amerikane e Investimeve mbështet për herë të parë në Shqipëri, projektin pilot mbi studimin e ADHD-së “Çrregullimit të Pamjaftueshmërisë së Vëmendjes me Hiperaktivitet” tek fëmijët e moshës 7-10, të ndërmarrë nga Medical Institute of Albania (MIA). Ky projekt do të shtrihet për një periudhë 18 mujore, me qëllim ndërgjegjësimin, parandalimin, identifikimin, diagnostikimin, trajtimin në kohë dhe rritjen e kapaciteteve të profesionistëve që menaxhojnë popullatën me ADHD.

- **NISMA VULLNETARE E “DHURIMIT TE GJAKUT”**

Banka Amerikane e Investimeve, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, për të tretin vit radhazi ndërmori nismën vullnetare të “Dhurimit të Gjakut”, në mbështetje të fëmijëve që vuajnë nga Talasemia. Stafi i bankës, me shumë përgjegjshmëri ju përgjigj thirrjes në mbështetje të kësaj kauze jetike.

- **SHOQATA “SYRI BLU”**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë, më 15 Tetor, Banka Amerikane e Investimeve mbështeti koncertin e organizuar nga ansambli i vokalit “Joy of Singing”, me qëllim aktivizimin në jetën artistike të personave me aftësi të kufizuara në shikim dhe ofrimin e shanseve të barabarta për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

- **MBËSHTETJA E 50 BIZNESEVE MIKRO DHE TE VOGLA TE PREKURA NGA TERMETI**

Nëpërmjet një partneriteti të ri të nënshkruar mes ABI Bank dhe UNDP Albania, ABI Bank financon një shumë prej 100.000 USD për të mbështetur 50 biznese mikro dhe të vogla në

rimëkëmbjen nga pasojat e tërmetit. Këto biznese do të mbështeten nëpërmjet metodologjisë "In Motion", e cila është aplikuar me sukses nga UNDP në vendet e prekura nga fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë edhe Shqipërinë. "In Motion" synon të stabilizojë kushtet ekonomike të bizneseve mikro dhe të vogla, të rivendosë dhe të përmirësojë veprimtaritë e tyre ekonomike në treg. ABI Bank do të mbështesë rinovimin e pajisjeve dhe modernizimin e imazhit tregtar të 50 bizneseve mikro dhe të vogla. Kjo do të ndihmojë në modernizimin e shërbimit ndaj klientit dhe përmirësimin e shitjeve. PNUD do të ofrojë ndihmë teknike të personalizuar, duke nisur nga diagnoza deri në planet e përmirësimit të biznesit.

- **FESTIVALI NDERKOMBETAR I VOKALIT OPERISTIK “MARIE KRAJA”**

Banka Amerikane e Investimeve, mbështeti edicionin e 18-të të Festivalit Ndërkombëtar të Vokalit Operistik “Marie Kraja”, që u zhvillua në datat 29 -30 Mars në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, si një event që synon promovimin dhe zhvillimin mes talenteve nga vende të ndryshme të botës, në fushën e artit operistik.

- **SWING MARATHON V**

ABI Bank mbështetëse e edicionit të 5-të Swing Marathon, një event i mbajtur në datën 30 Prill në Shkodër, nën tingujt e muzikës Jazz & Swing.

- **FESTIVALI GJON MILI**

Në kuadër të festivalit Gjon Mili dhe Javës Amerikane në Korçë, Banka Amerikane e Investimeve mbështeti “videoLAB” në Muzeun Gjon Mili, një laborator të pajisur me mjetet e domosdoshme për të rinjtë e apasionuar në video art dhe fotografi, të cilët do të kenë mundësi të shprehin dhe zbulojnë talentin e tyre.

- **LAND & SAND ART FESTIVAL**

“Land & Sand Art Festival”, u zhvilluar për herë të parë në Shqipëri, si një risi e artit në rërë. Artistë nga vende të ndryshme të Evropës u bënë bashkë për të ndërtuar në bregdetin e Velipojës skulpturat e tyre prej rëre.

- **EVENTI PER 110-VJETORIN E PAVARESISE KOMBETARE**

Banka Amerikane e Investimeve në çilesinë e sponsorit gjeneral, mbështet eventin e organizuar në Vlorë, për 110-vjetorin e Pavarësisë Kombëtare. Eventin i zhvilluar përgjatë tre ditëve, 26-28 Nëntor, konsistonte në një sërë aktivitetesh të ndryshme si ekspozite fotografike, panair kulinarie, konference akademike, festivali isopolifonik i fëmijëve & gare ciklizmi.

- **MUSICAL “JESUS CHRIST SUPERSTAR”**

ABI bank sponsorizoi eventin Musical “Jesus Christ Superstar”. Premiera e dhene në datat 28 – 29 dhe 30 Dhjetor u zhvillua në ambjentet e teatrit “Arturbina”. Ky musical është një nga kryeveprat e artit modern, që me suksesin e saj njihet si vepra që transformoi historinë e teatrit muzikor. Subjekti i saj lidhet me ditët e fundit të Jezusit, të para nga perspektiva e Judes, njeriut që e tradhetoi.

7. Trajnime

Gjatë gjithë vitit 2022 ABI Invest Sh.A ka organizuar trajnime me personelin shitës të Bankës Amerikane të Investimeve. Këto trajnime kanë patur karakter edukues dhe informues. Gjithashtu takime informuese dhe sqaruese organizohen në çdo rast dhe me investiturë egzistues apo potenciale.

8. Fondet e Investimit

Gjatë vitit 2022 ecuria e ekonomisë shqiptare ishte pozitive, ndërkohë që Banka e Shqipërisë rriti disa herë normën bazë të interesit në përgjigje të rritjes së inflacionit. Kjo rritje ndikoi në rritjen e yield-it të Obligacioneve dhe Bonove të Thesarit të emtuar nga Qeveria Shqiptare.

Ndërkohë në lidhje me tregjet ndërkombëtare, rritja globale e inflacionit ndikoi politikën monetare të bankave qendrore kryesore si Banka Qendrore Europiane të cilat gjithashtu vazhduan procesin e normalizimit të politikës monetare duke rritur normat e interesit.

ABI Invest administron tre fonde investimi. ABI EIA i cili emeton dhe shlyen kuota në monedhën LEK, ABI FLEX EURO i cili emeton dhe shlyen kuota në monedhën EUR dhe ABI FLEX USD i cili emeton dhe shlyen kuota në monedhën USD.

Të dhënat për fondet e investimeve nën administrimin e ABI Invest 31 Dhjetor 2022

	ABI EIA	ABI FLEX EURO	ABI FLEX USD
Çmimi i Kuotës	1,012.8876	90.4829	93.2441
NAV	338,616,056.81	2,534,763.86	466,746.41

Tarifat e fondeve nën administrimin e ABI Invest

	ABI EIA	ABI FLEX EURO	ABI FLEX USD
Tarifa e Administrimit në bazë vjetore	1.00%	2.00%	2.00%

8.1 Fondi ABI EIA

Fondi ABI EIA është i emeton dhe shlyen kuota në monedhën Lekë. Objektivi i fondit është të maksimizojë kthimin afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të investojë kryesisht në letra me vlerë të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi i Investimit nuk aplikon tarifa hyrjeje dhe daljeje.

Fondi nisi aktivitetin në Mars të vitit 2021.

Investimet e kryera në fond janë kryesisht në obligacione afatshkurtër dhe afatgjatë ku gjithashtu ka dhe bono thesari deri në 12 muaj. Likuiditeti i tepërt mbahet në depozita afatshkurter në banka lokale.

8.1.1 Performanca

Fondi ka nisur aktivitetin në Mars të vitit 2021 dhe nga fillimi i aktivitetit deri më 31 Dhjetor 2022, fondi ka realizuar një kthim neto prej 1.29%. Ndërkohë për periudhën 31 Dhjetor 2021 – 31 Dhjetor 2022 fondi ka realizuar një kthim neto prej -0.79%.

8.2 Fondi ABI FLEX EURO

Fondi ABI FLEX EURO emeton dhe shlyen kuota në monedhën Euro.

Qëllimi i investimit të Fondit është realizimi i një rritje të moderuar të kapitalit në një periudhë afatmesme, nëpërmjet investimeve në klasa ndryshme aktivesh, duke përzgjedhur strategji të përshtatshme diversifikimi.

Si i tillë fondi synon të investojë në obligacione, aksione apo sipërmarrje të tjera investimesh kolektive të klasifikuara si UCITS, dhe gjithashtu mund të investojë deri në 30% të totalit të aktiveve në sipërmarrje të investimeve kolektive të cilat nuk janë të klasifikuara si UCITS.

Investimet në sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive do të përzgjidhen duke marrë parasysh cilësinë e procesit të investimit, performancën e tyre deri në datën e investimit si dhe menaxhimin e tyre të riskut. Fondi është i përshtatshëm për ata investitorë që janë të gatshëm të ndëmarrin një nivel më të lartë risku dhe përfitimi duke investuar në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

8.2.1 Performanca

Fondi ka nisur aktivitetin në Nentor të vitit 2021 dhe nga fillimi i aktivitetit deri më 31 Dhjetor 2022, fondi ka realizuar një kthim neto prej – 9.52%. Ndërkohë për periudhën 31 Dhjetor 2021 – 31 Dhjetor 2022 fondi ka realizuar një kthim neto prej -9.65%.

8.3 Fondi ABI FLEX USD

Fondi ABI FLEX USD emeton dhe shlyen kuota në monedhën USD.

Qëllimi i investimit të Fondit është realizimi i një rritje të moderuar të kapitalit në një periudhë afatmesme, nëpërmjet investimeve në klasa ndryshme aktivesh, duke përzgjedhur strategji të përshtatshme diversifikimi.

Si i tillë fondi synon të investojë në obligacione, aksione apo sipërmarrje të tjera investimesh kolektive të klasifikuara si UCITS, dhe gjithashtu mund të investojë deri në 30% të totalit të aktiveve në sipërmarrje të investimeve kolektive të cilat nuk janë të klasifikuara si UCITS.

Investimet në sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive do të përzgjidhen duke marrë parasysh cilësinë e procesit të investimit, performancën e tyre deri në datën e investimit si dhe menaxhimin e tyre të riskut. Fondi është i përshtatshëm për ata investitorë që janë të gatshëm të ndëmarrin një nivel më të lartë risku dhe përfitimi duke investuar në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

8.3.1 Performanca

Fondi ka nisur aktivitetin në Mars të vitit 2021 dhe nga fillimi i aktivitetit deri më 31 Dhjetor 2022, fondi ka realizuar një kthim neto prej -6.76%. Ndërkohë për periudhën 31 Dhjetor 2021 – 31 Dhjetor 2022 fondi ka realizuar një kthim neto prej -6.76%.

9. Treguesit e Riskut

Administrimi i Riskut kryhet në mënyrë të pavarur dhe monitoron, mat dhe raporton respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të riskut. Gjatë 2022, të gjitha limitet ligjore si dhe ato të deklaruara në prospektet e fondeve janë respektuar.

Fondi i Investimit	Kohëzgjata e modifikuar	Luhatshmeria	Treguesi sintetik i Riskut Dhe Perfitimit
ABI EIA	0.29	0.59%	Niveli 3
ABI FLEX EURO	0.99	7.37%	Niveli 5
ABI FLEX USD	0.34	6.44%	Niveli 5

Indikatorët janë për datën 31 Dhjetor 2022 dhe tregojnë të dhënat për periudhën nga nisja e aktivitetit të fondit deri më 31 Dhjetor 2022.